

**STATUT E AKTHEMELIMI I
SHOQERISE TREGTARE**
“International Rating Service” Sh.p.k

**KREU I :
EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA**

Kreu 1

NENI 1

Ne Tirane, sot me daten 29/03/2018 (dy mije e tetembedhjete), Shoqeria ‘Vero Consulting’ Shpk me seli Rr. Ismail Qemali, Njesia Administrative nr 5, Nderresa 14, Hyrja 4, Apartamenti 5, Tirane,Shqiperi, e regjistruar prane QKB me NIPT: e perfaqesuar nga:

- Z.Denis Kuçi, i datelindjes 03/09/1994, lindur dhe banues ne Shqiperi, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti nr. 029868047.

Me vullnet të lire të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak i vetem vendos te hartoje kete Statut e Aktthemelimi mbeshtetur ne nenet e meposhtme e si dhe ne dispozitat ligjore si;

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
LIGJIN ME NR 9901 DATE 14.04.2008 “PËR TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE”

NENI 2

Shoqeria tregtare eshte vendase dhe emertohet “International Rating Service” ose shkurtimisht ‘IRS’ ,emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia e shoqerise “International Rating Service” eshte ne Rr. Ismail Qemali, Njesia Administrative nr 5, Nderresa 14, Hyrja 4, Apartamenti 5, Tirane,Shqiperi.

NENI 4

Shoqeria “International Rating Service” shpk do te kete si objekt te veprimtarise te saj;

Aktivitet konsulence, studimesh dhe kerkime tregu, aktivite promovionale per nisma tregtare, industriale dhe zhvillimi te aktiviteve;

Berjen e kerkimeve te tregut ne lidhje me nisma prodhuese per pasuri dhe/ose sherbime;

Furnizimin e sherbimeve te business information;



Monitorimi dhe ruajtja e nismave sipermarrese,

Dhënie shërbimesh, edhe në kuadër të të treta, me qëllim promovimin e zhvillimit të racionalizimit të administrimit të ndërmarrjeve;

Dhënie e shërbimeve administrative, teknike, tregtare dhe financiare:

Asistencën tekniko - ekonomike për ndërmarrjet për përfundimin e financimeve dhe/ose kontributeve që të shërbejnë për marrjen e lehtësimeve në nivel kombëtar ose të komunitetit ndërkombëtar;

Dhënie shërbimesh dhe realizimet e studimeve për të optimizuar administrimin e ndërmarrjeve, enteve dhe konsorciumeve, kooperativave, nëpërmjet ndërhyrjeve të organizimit, ristrukturimit, kontrollit të administrimit, planifikimit financiar, kontrollit sasior dhe cilësor të prodhimit, dhe të kostove perkatëse, aplikimin e metodologjive të veta dhe të të treta, koordinimin teknik, logjistik, tregtar, financiar, dhe të promovimit të ndërmarrjeve, analizën e risqeve për ndërmarrjet (risk management).

Shërbime informacioni, konsulence dhe asistencë për ndërmarrjet për gjetjen dhe përdorimin më të mirë të burimeve financiare, përfshirë një shërbim grumbullimi dhe shpërndarje të informacioneve të përshtatshme për të lehtësuar aksesin për kredi;

Aktivitet konsulence të specializuar për të korporuar financa dhe suport në zgjedhjet strategjike të financimit dhe të ristrukturimit;

Të japë konsulence dhe asistencë në operacionet e financës së jashtëzakonshme.

Të japë konsulence dhe asistencë në operacionet e blerjes, shitjes dhe vlerësimeve të ndërmarrjeve.

Të përgatitë studime fizibiliteti, të përcaktojë nevojat financiare dhe të gjejë mjetet e mbulimit edhe të lehtësuar, analize të kthimeve ekonomike, analiza dhe vlerësime hipoteke, markash dhe patentash, gjetjen, konsolidimin, transferimin e eksperiencës së ndërmarrjes, kërkim, promovim të joint venture.

Të promovojë dhe të mbështesë operacione të projekt financim.

Të aktivizojë kapitale private për realizimin e investimeve me interes për territorin kombëtar.

Konsulence për tematikat fiskale,

Konsulence në fushën e së drejtës tregtare dhe fiskale, për blerjet publike, koncesionet dhe privatizimet, për pronësinë intelektuale dhe të drejtat e autorit, si edhe në fushën e së drejtës në përgjithësi.

Përfaqesim të shoqërive tregtare, individuale dhe të çdo subjekti tjetër me personalitet juridik në çdo procedurë administrative në Republikën e Shqipërisë ose jashtë shtetit; Përgatitjen e relacioneve ekonomiko-financiare për shoqëri tregtare dhe për persona të tjera juridike/fizike; Ndermjetësim, pajtim, mbështetje në negociim;

Organizim mbajtje, koordinim seminaresh, simposiumesh, takimesh, planesh dhe kursesh studimi kolektive dhe individuale, formim të personelit (me përjashtim të ndermjetësimit në kolokim).

Botim manualesh, buletinesh të ndryshme, periodike dhe jo periodike, produktesh editorial periodike dhe jo periodike, kompozime botimesh, pune në parastampim me përjashtim të gazetave të përditshme, në fushën e shërbimeve profesionale;

Tregtim software.

Konsulence për projektimin dhe administrimin e platformave dixhitale.

Parapërgatitje dhe furnizim direkt dhe indirekt i shërbimeve informatike, telematike, të marketingut, të trajnimit dhe të suportit logjistik të integruar, për zhvillimin e tregtisë si tradicionale ashtu edhe elektronike të çdo aktiviteti tjetër, si nëpërmjet internetit dhe rrjeteve të tjera telematike, ashtu edhe nëpërmjet kanaleve tradicionale.

Kryerja e fushatave të marketingut dhe shërbimeve të tjera të reklamimit që synojnë tërheqjen dhe sigurimin e besnikërisë së klientëve;

Projektim, zhvillim, testim dhe mirembajtje të programeve software;

Projektim e zhvillim të sit-eve web dhe aplikimeve mobile;

Furnizim software dhe konsulence informatike;

Projektim dhe planifikim i sistemeve informatike që integrojnë hardware-t e kompiuterave, software-in dhe teknologjite e komunikacionit;

Dhënie shërbimesh për aplikimin, organizimin dhe zhvillimin e teknologjive të informatikes;

Konsulence dhe instalim të përpunuesve elektronike;

Përpunim elektronik i të dhënave;

Aktivitet manaxhimi, mirembajtje evolutive dhe korrektuese, integrim dhe heqje të database-ve;

Tregti me shumicë dhe me pakicë të sistemeve informatike hardware dhe software dhe dhënie shërbimesh të nderlidhur nëpërmjet instalimit dhe mirembajtjes;

Aktivitet formimi të personelit në fushën e informatikes, përditësim, kualifikim profesional në kuadrin ICT dhe të teknologjive informatike edhe nëpërmjet kryerjes së kurseve teknike aplikative pranë enteve private dhe publike;

Marrje e mandateve të agjensisë dhe përfaqësimit për software, shërbime informatike, kompiuter, aksesore elektronike dhe material elektronik;

Manaxhim i strukturave dhe aparateve informatike hardware - housing;

Shërbime të tjera të lidhura me informatikën;

Aktivitete kërkimi, studio, llogari, konsulence, manaxhim projekti, financim projekti, studime fizibiliteti teknik dhe ekonomik-financiar, konsulence strategjike, ndihme teknike, edhe në fushën e cilesisë së ndërmarrjes, sigurim dhe higjënë në punë dhe në ambientet e punës;

Konsulence biznesi dhe konsulence administrative/manaxheriale (konsulence e specializuara);

Shërbime kërkimi, seleksionim dhe vlerësim i personelit;

Shoqëria mund të gjithashtu të kryejë çdo operacion tregtar, industrial, të levizshme, të palevizshme, dhe financiare, i quajtur nga organi administrativ si i dobishëm, oportun dhe funksionalisht i lidhur me realizimin e objektit të shoqërisë.

Aktivitete të tjera profesionale të përmendura tjetërkund (konsulence manaxheriale, organizim i panairëve dhe kongrese).


Aktivitete importi dhe eksporti të shërbimeve dhe produkteve të lidhura me informatikën dhe objektin e saj social.

Shoqëria mund të marrë dhe japë përfaqësime dhe agjensi, edhe në shoqëri të huaja, në lidhje me shërbimet dhe produktet e trajtuara.

Vetëm për qëllimin e arritjes së objektit të shoqërisë, jo për qëllime kolokimi, dhe që kjo të mos përbejë aktivitetin mbizotërues, shoqëria mund të marrë pjesëmarrje dhe kuota në shoqëri të tjera me qëllime të ngjashme ose analoge ose sido qoftë të lidhura me të vetin.

Shoqëria mund të bëjë të gjitha aktivitetet tregtare, industriale, financiare, mobiliare dhe imobiliare që do të konsiderohen nga organi administrativ instrumentale, aksesore të lidhura, të nevojshme ose të dobishme për realizimin e aktiviteteve që përbejnë objektin e shoqërisë.

Shoqëria mund të marrë pjesë direkt ose indirekt në ankande, tendera, në sektorin publik ose privat, në lidhje me dhënie të shërbimeve dhe punimeve të përshkruara në objektin e shoqërisë.



Shoqeria mund te jete destinuese e financimeve dhe porosive nga ana e enteve kombetare dhe nderkombetare, publike dhe private, per aktivitete te promovimit industrial dhe per zhvillimin e ndermarjeve si edhe per aktivitetet e tjera ne lidhje me objektin e shoqerise.

Per kryerjen e aktiviteteteve shoqeria do te shfrytetoje edhe suportin e profesionisteve rregullisht te rregjistruar ne urdhrat profesionale ne respektim te dispozitave ligjore ne kete fushe.

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 leke (njeqind) formuar dhe nenshkruar nga ortaket i perbere nga 1 kuote si me poshte ;

- Vero Consulting Shpk, zoteruese e 1 (nje) kuote, me pjesmarrje ne perqindje 100%

I depozituar sipas ligjit

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise eshte e papercaktuar duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit ne QKB, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit te saj.

KREU II:

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetere, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj. Ortaket dhe administratori i saj, depozitojne faksimilet e firmave te tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria .



NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaket kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikës se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre e perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje të tille vendimet e asamblese se ortakeve te shoqerise duhet të merren paraprakisht me shkrim. Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 10

Me vendim të ortakeve te shoqerise, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime të tjera të cilat jane me interes per mbarvajtjen e shoqerise.

NENI 11

Shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose disa ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, duke parashikuar te drejten e parablerjes kundrejt ortakeve te saj, ose nepermjet operacioneve te jashtezakonshme te shkrirjes ose blerjes me nje person juridik, si ne Shqiperi dhe jashte saj.

KREU III :

ORGANET DREJTUESE TË SHOQERISE DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKES TË VETME

NENI 12


Asambleja e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe nihen nga ligji ne fuqi.

NENI 13

Adminstrator i shoqerise eshte Z.Denis Kuçi, me nr. leternjoftimi 029868047 me afat 5- vjecar . Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukture te shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.



NENI 14

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit ne QKB, per njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar të kesaj qendre. Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të jete rregjistruar dhe paisur me certifikatat perkatese ne Organin e Tatim Taksave Tirane.

NENI 15

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe ate Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarise se saj, mbi bazen e Aktit të Themelimi dhe Statutit të saj dhe normat e se drejtes tregtare nderkombetare.

NENI 16


Asambleja e Ortakeve e shoqerise ka dhe keto të drejta dhe detyra kryesore :

- Të marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të cdo veprimtarie tjeter të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- Të kerkoje dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria, ato qe kane të bejne me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të bilancit kontabel apo per cdo llogari të celur si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese.
- Të marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cfaredo forme apo sasi, sipas kontributit të dhene prej tij.
- Të kryeje sherbime per realizimin e objektivave dhe qellimeve të veprimtarise se rregullt ligjore të Shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon ne cdo kohe Administratorin e shoqerise, cakton ekspertin kontabel të autorizuar.
- Ekspertin kontabel të autorizuar e ngarkon per pregatitjen dhe nxjerrjen e bilancit vjetor ekonomiko financiar të aktivitetit të shoqerise, të cilin ia paraqesin ortakeve mbi bazen e raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit të tij, ortaket kane të drejten e miratimit vendimor të ketij bilanci.

Nxjerrja e bilancit financiar vjetor mbi bazen e të dhenave të kontabilitetit, behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Asambleja e Ortakeve kryesisht si dhe Administratori , ushtrojne të drejten per të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane të domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures të veprimtarise tregtare të shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave të saj sic mund të jene :

1. Të lidhin kontrata të ndryshme qe kane per objekt blerjen, shitjen, kembimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizik dhe ata juridike, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe ne rast të blerjes se pasurive të



- paluajtshme, të bëjnë dhe transkriptimin e pronësive se saj në favorin e tyre në Hipotekën e ZRPP, për të dokumentuar një rrethana të tillë dhe si shtesë të kapitalit në natyrë.
2. Të kryejë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private dhe shtetërore, Bankat e çdo niveli etj. që kanë të bëjnë me Garancitë, sipërmarrjet, marrjen e kredive, siguracioneve, transportit brenda dhe jashtë shtetit), për zhdoganimin e mallrave dhe shërbimeve të importuara apo eksportuara, ato të plotësimin me korrekte të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes në kohë të çdo detyrimi. Në rastet kur këto veprime juridike kryhen nga administratori i emëruar nga ortakët i vetëm ose personi që e përfaqëson atë mbi bazën e prokurës, këta në përfundim të realizimit të veprimit përkatës detyrohen që të njoftojnë menjëherë dhe t'i japin llogari ortakut të vetëm.
 3. Administratori ose përfaqësuesi me prokurë janë individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë Statut dhe për dëmin e shkaktuar me faj, sipas rasti, Ortaku mund të ngrejë dhe të kërkojë ndaj tyre përdorim të shlyerjes së dëmit civil, duke përfshirë dhe të drejtën për të bërë kallezim për ndjekje penale në Prokurorinë e juridiksionit territorial ku ka selinë shoqëria.

NENI 17

Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme ose të kualifikuar, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 75% të kuotave.

Për të përmbushur kuorumin ortakët që nuk kanë mundësi të marrin pjesë kanë të drejtë të autorizojnë një person të tretë ose një ortak tjetër me një prokurë të thjeshtë, dhe të deleguarit me firmë nga deleguesi.

NENI 18

Përfaqësimi i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët si brenda dhe jashtë shtetit si rregull i përgjithshëm i përket Administratorit të shoqërisë.

NENI 19

Asambleja e Ortakëve, kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, duke lidhur kontrata sipas kritereve që parashikohen në Kodin e Ri të Punës në fuqi dhe me ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 " Për sigurimet shoqërore " të ndryshuar si dhe në përshatje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës të caktuara nga vete punëdhënësi.

KREU IV



BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 20

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqerise, mbyllen me daten 31 Dhjetor të cdo viti. Per nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve nje ekspert kontabel i autorizuar.

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve .Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe kane.

NENI 21

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per tu zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtare.

NENI 22

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.


NENI 23

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimit e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

NENI 24

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimet të metejshem të veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji “ Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare”
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.



Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

NENI 25

Afati i emerimit të likuiduesit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen deponuar ne Aneksin e Regjistrimit Tregtar.

NENI 26

Likuiduesi eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

NENI 27

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten ceshtjen mund të behet objekt konflikti gjyqsor ne Gjykates e Rrethit Gjyqsor Tirane.

NENI 28

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet udhezimeve plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Ortakeve si dhe legjislacioni ne fuqi.

NENI 29

Ky statut u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, 2 ne gjuhen shqipe dhe 2 ne gjuhen italian pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

VERO CONSULTING

E perfaqesuar nga Denis Kuçi

